



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

---

## RAPORT ME REKOMANDIME

### I

### MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

### PËR

### VIZITËN NË QENDRËN E PARABURGIMIT NË LIPJAN

**Për:**

**Z. Abelard Tahiri, Ministër**  
**Ministria e Drejtësisë**

**Z. Uran Ismaili, Ministër**  
**Ministria e Shëndetësisë**

**Z. Nehat Thaqi, Drejtor i Përgjithshëm**  
**Shërbimi Korrektues i Kosovës**

**Z. Milazim Gjocaj, Drejtor**  
**Departamenti i Shëndetësisë në Burgje**

**Z. Arif Beqa, Drejtor**  
**Qendra e Paraburgimit në Lipjan**

**Prishtinë, 16 gusht 2019**

## HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 29 maj 2019, e ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Lipjan (në tekstin e mëtejme *QPL*).

MKPT-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Në QPL, përveç të paraburgosurve, vendosen edhe një numër i vogël i të dënuarve. Gjatë vizitës së MKPT-së në QPL ishin të akomoduar 89 të paraburgosur (68 të paraburgosur dhe 21 të dënuar).

### Qëllimi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

### Përbërja e grupit monitorues

1. Grupi monitorues përbëhej prej një këshilltari të lartë juridik për parandalim të torturës, një këshilltare juridike për parandalim të torturës, një psikologe-këshilltare, një mjekë-këshilltare dhe një punëtoreshë sociale-këshilltare.

### Bashkëpunimi i QPL-së me MKPT-në gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës së MKPT-së në QPL, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës (në tekstin e mëtejme ShKK) dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara dhe iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën, si dhe iu mundësuan bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe pa praninë e personelit shëndetësor.

### Informimi për të drejtat e të burgosurve

3. Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese (më tej *Rendi Shtëpiak*) përcakton obligimet e institucioneve korrektuese që, menjëherë pas pranimit, të sigurojnë kushte që i burgosuri të njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet e tij. Më tej, Rendi Shtëpiak përcakton se *Rendi Shtëpiak* dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (tani e tutje *LESP*) janë në dispozicion të të burgosurve gjatë gjithë kohës. I burgosuri, i cili nuk di shkrim dhe lexim, njoftohet gojarisht për të drejtat dhe obligimet.<sup>1</sup> MKPT-ja, gjatë vizitës, vërejti se në dispozicion të të burgosurve janë Rendi Shtëpiak dhe dokumente tjera relevante, përmes së cilave të burgosurit njoftohen për të drejtat dhe obligimet e tyre.

---

<sup>1</sup> Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 20.

## Keqtrajtimi fizik

4. MKPT-ja, gjatë vizitës në QPL, intervistoi një numër të konsiderueshëm të burgosurish dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike të ushtruar nga zyrtarët korrektues apo për sjellje të autoriteteve të burgut, të cilat do të përbënin shkelje të dinjitetit të të burgosurve. Përveç kësaj, MKPT-ja vërejti se ekziston një klimë pozitive e marrëdhënieve dhe komunikim i mirë interaktiv ndërmjet të dënuarve dhe zyrtarëve korrektues.

## Kushtet e akomodimit

5. LESP-ja shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë për strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.<sup>2</sup> Më tej ky ligj përcakton: *“Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.”*<sup>3</sup>
6. MKPT-ja vërejti se kati i parë i QPL-së ishte rinovuar tërësisht dhe tani ofron kushte shumë të mira për akomodim të të burgosurve. Po ashtu, në këtë kat janë përmirësuar dukshëm kushtet e punës për zyrtarët korrektues dhe për personelin e DShB-së. Përveç katit të parë, u rinovuan edhe objekti i njësisë së transportit, salla e vizitave familjare dhe dhoma e kontrollit.
7. MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se qelitë ku qëndronin të burgosurit, në katin e parë të QPL-së, kishin ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, si dhe nuk kishin lagështi. Sa i përket hapësirës për banim për të burgosurit, MKPT-ja vërejti se, në përgjithësi në QPL, hapësira për banim është në pajtim me dispozitat e LESP-së dhe me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm *KPT*).<sup>4</sup> Po ashtu, MKPT-ja, gjatë vizitës në QPL, nuk vërejti mbipopullim.
8. Megjithatë, kushtet e akomodimit në katin e dytë dallojnë dukshëm nga ato në katin e parë dhe nevojiten rinovime sa më shpejt që të jetë e mundur. Sipas drejtorit, në këtë kat të QPL-së priten investime nga autoritetet kompetente. Dushet dhe tualetet në përgjithësi janë në gjendje të mirë teknike dhe janë në dispozicion të të paraburgosurve çdo të dytën ditë të javës, ndërsa për të dënuarit nuk ka kufizime.
9. Si edhe në shumicën e qendrave tjera korrektuese, edhe në QPL, MKPT-ja vërejti se dyshekët e shtretërve janë të vjetruar dhe nuk janë ndërruar për kohë të gjatë dhe, si pasojë, në disa shtretër ka depërtuar lagështia. Drejtoria e QPL-së është e vetëdijshme për këtë mangësi dhe ka drejtuar kërkesë në organet kompetente të ShKK-së.
10. Po ashtu, të burgosurit shprehën shqetësimin e tyre për faktin se nëpër qelitë e tyre nuk ka frigoriferë dhe gjatë stinës së verës, me ngritjen e temperaturave, ekziston rreziku permanent që disa gjëra ushqimore të prishen dhe ata të helmohen. MKPT-ja këtë çështje e ka shtruar para drejtorit nga i cili u njoftua se është i vetëdijshme për këtë çështje dhe se

<sup>2</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 1.

<sup>3</sup> Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

<sup>4</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449/>

është në kërkim të zgjidhjes adekuate. MKPT-ja do të vazhdojë të monitorojë në të ardhmen situatën lidhur me këtë çështje.

## Ushqimi

11. LESP-ja përcakton të drejtën e të burgosurve për ushqim të përshtatshëm, për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tyre, me tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojllojshme. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore.<sup>5</sup>
12. Më tej ligji përcakton se personi i dënuar, i cili kryen punë të rënda, personi i sëmurë, gruaja shtatzënë, ose ajo e cila ka lindur fëmijë, kanë të drejtë për ushqim të caktuar nga mjeku edhe për ushqim dietal.<sup>6</sup> Mjeku, ose eksperti tjetër për ushqim, e kontrollon ushqimin dhe, para shërbimit të çdo shujte, e njofton drejtorin e institucionit korrektues për cilësinë e ushqimit dhe konstatimet e tij i shënohen në librin përkatës.<sup>7</sup>
13. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejt se kushtet higjienike në kuzhinë ishin në nivelin e duhur dhe kuzhina ishte e pajisur me pajisjet e nevojshme për ta kryer punën në përgatitjen e ushqimit. Stafit i kuzhinës ishte i pajisur me libreza sanitare. Përveç stafit, të pajisur me libreza sanitare ishin edhe të dënuarit e angazhuar në punë. QPL-ja ka një meny ushqimore me produkte të nevojshme dhe të pasura me kalori të mjaftueshme. Po ashtu, QPL-ja ofron për të burgosurit ushqim dietal, sipas rekomandimit të mjekut. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga të burgosurit sa i përket sasisë dhe cilësisë së ushqimit që u shërbehet.

## Regjimi

14. Në QPL janë të angazhuar në punë 23 të dënuar dhe vetëm katër të paraburgosur. Të burgosurit mund të angazhohen në punë në kuzhinë, për pastrim, për mirëmbajtje të objektit, në lavanteri dhe në kopshtin e QPL-së, në të cilin aktualisht ishin të angazhuar në punë 4 të burgosur. Të burgosurit kanë në dispozicion dy orë e gjysmë shëtitje gjatë ditës. Në dispozicion të tyre janë edhe dy fusha sportive, të cilat janë të shtruara me beton dhe, për pasojë, ndodh shpesh që gjatë lojës të burgosurit edhe të lëndohen.
15. Aktivitetet sportive në dispozicion mund të zhvillohen gjatë kohës kur të burgosurit dalin në shëtitje. Sa u përket trajnimeve dhe kurseve të edukimit, tani për tani, në QPL zhvillohet programi EQUIP, në kuadër të të cilit janë të angazhuar 6-7 të burgosur. Dhomat e të burgosurve janë të pajisura me TV, por ende nuk është instaluar sistemi kabllor i TV-së, edhe pse sipas drejtorit, një gjë e tillë është në plan.
16. Në rastin e të paraburgosurve, angazhimi i tyre në punë varet nga leja e gjykatës. MKPT-ja vëren se, sa i përket angazhimit të të paraburgosurit në punë, neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e*

<sup>5</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 1.

<sup>6</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 2.

<sup>7</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 3.

*dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.”*

17. Ndërsa neni 200, paragrafi 1, i LEPS-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente.”*
18. Po ashtu, Rregullat e Mandelës përcaktojnë të drejtën e të paraburgosurit për të punuar. Në Rregullin 116 të Rregullave të Mandelës shprehimisht theksohet: *“Të paraburgosurit duhet t’i ofrohet mundësia të punojë, por nuk duhet ti kërkohet të punojë. Nëse ai/ajo përcaktohet që të punojë, ai/ajo duhet të paguhet.”*
19. Në raportin e KPT-së për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, i cili ishte publikuar në vitin 2016, KPT-ja, lidhur me regjimin për të paraburgosurit, shprehu shqetësimin se, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve, të paraburgosurit shumicën e kohës e kalojnë në qelitë e tyre, duke shikuar TV dhe duke luajtur me letra, përveç dy orëve të shëtitjes në ditë.
20. Përmes këtij raporti, KPT-ja u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente në Republikën e Kosovës si në vijim: *“KPT, ri-përsërit rekomandimin që autoritetet të angazhohen që të rrisin aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit në të gjitha institucionet të cilat KPT i vizitoi, dhe në të gjitha institucionet tjera të Shërbimit Korrektues të Kosovës ku një gjë e tillë është e përshtatshme. Më tej KPT thekson: “sa më e gjatë që është periudha e paraburgimit, aq më shumë duhet të zhvillohet regjimi i cili u ofrohet atyre. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që edhe numri i personelit, ku një gjë e tillë është e nevojshme, të rritet.”<sup>8</sup>*
21. MKPT-ja konsideron se, bazuar në legjislacionin në fuqi, në Rregullat e Mandelës dhe në rekomandimet e KPT-së, autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit jo vetëm në QPL, por edhe në qendrat tjera të paraburgimit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

### **Incidentet ndërmjet të burgosurve**

22. Autoritetet e burgut kanë obligime pozitive për ta parandaluar dhunën ndërmjet të burgosurve për të cilët ata janë përgjegjës. Bazuar në dokumentacionin relevant, gjatë këtij viti, në QPL janë regjistruar gjashtë incidente ndërmjet të burgosurve. Në përgjithësi bëhet fjalë për rrahje ndërmjet të burgosurve. Nga dokumentacioni i analizuar del se drejtori, pas shqyrtimit të rasteve, i ka ndërmarrë veprimet e parapara me LEPS dhe në disa raste ka shqiptuar edhe masa disiplinore, për të cilat, në rastin e të paraburgosurve, u njoftua edhe gjykata kompetente.

### **Kujdesi shëndetësor**

23. Neni 43 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë për shërbime shëndetësore pa pagesë. Personi i dënuar, të cilit nuk mund t’i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues, dërgohet në spitalin e burgut, në

---

<sup>8</sup> Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë, publikuar në shtator 2016, paragrafi 46. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër për përkujdesje shëndetësore.<sup>9</sup>

24. Personeli mjekësor i QPL-së përbëhet nga një mjekë me orar të plotë, e cila është në dispozicion të thirrjet telefonike, një kryeinfermier dhe pesë infermiere, ku tre prej tyre punojnë me ndërrime 12 orëshe dhe një psikologe që punon me orar të rregullt 8 orësh. Stomatologu është në dispozicion njëherë në javë dhe vjen nga Qendra Korrektuese për Femra dhe të Mitur. Sa u përket shërbimeve tjera specialistike, ato kryhen në koordinim me qendrat e mjekësisë familjare, me spitalet regjionale dhe me klinikat përkatëse të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).
25. MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se ka mungesë të stafit të mesëm (një infermiere mban kujdestarinë aktualisht në tri qendrat korrektuese në Lipjan). Kurse sa i përket infrastrukturës, njësia shëndetësore e ka dhomën ku kryhen vizitat mjekësore, dhomën e mjekut EKG, bombol oksigjeni, defribilator, tensiometër, material shpenzues dhe shok-terapinë.
26. Sa i përket infrastrukturës ku ofrohen shërbimet mjekësore, pas rinovimit të katit të parë, kushtet e punës për personelin e DShB-së janë përmirësuar dukshëm. Prandaj, MKPT-ja konsideron se është zbatuar rekomandimi i saj për të siguruar kushte më të mira të punës për personelin shëndetësor. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga të burgosurit lidhur me respektimin e së drejtës për shërbime mjekësore.
27. Sipas drejtorit të QPL-së, vazhdon të jetë sfidë prezenca e kohëpaskohshme e të burgosurve me sëmundje mendore, për shkak të mungesës së kapaciteteve për t'i akomoduar në institucione përkatëse të burgosurit e kësaj kategorie.
28. Në këtë drejtim, standardet e KPT-së përcaktojnë si në vijim: *“Një i burgosur i sëmurë mendor duhet të mbahet dhe përkujdeset në një mjedis spitalor që është i pajisur përshtatshëm dhe që ka personelin e trajnuar siç duhet. Ai mjedis mund të jetë një spital psikiatrik civil ose një mjedis psikiatrik i pajisur posaçërisht brenda sistemit të burgut.”*<sup>10</sup>
29. Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 12.1, përcaktojnë si në vijim: *“Personat të cilët vuajnë nga sëmundjet mendore të cilat nuk janë kompatible me akomodimin në burg duhet të akomodohen në institucionin e paraparë veçanërisht për këtë qëllim.”*<sup>11</sup>
30. Rregullat e Mandelës, Rregulli 109, përcaktojnë se të burgosurit me probleme mendore nuk duhet të mbahen në burgje, por duhet të bëhen përpjekje që ata të transferohen në institucione përkatëse sa më shpjet që të jetë e mundur.
31. MKPT-ja inkurajon autoritetet kompetente që të bëjnë përpjekje të vazhdueshme që këta persona të trajtohen në institucione përkatëse, qoftë në ndonjë njësi të veçantë psikiatrike brenda burgut, në ndonjë spital, apo në institucion psikiatrik civil.

### **Rëndësia e kontrolleve mjekësore për të burgosurit e sapo pranuar**

32. KPT-ja vazhdimisht thekson rëndësinë e ekzaminimit mjekësor të të burgosurve të sapo pranuar, veçanërisht në institucionet të cilat përbëjnë pikë hyrjeje në sistemin e burgjeve.

<sup>9</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 43, par. 2.

<sup>10</sup> Standardet e KPT-së, pjesë nga Raporti i 3-të i Përgjithshëm, paragrafi 43, publikuar në vitin 1993. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

<sup>11</sup> Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 47.1. Shih në: <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae>.

Një ekzaminim i tillë është esencjal, veçanërisht për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve transmetuese (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).

33. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut po ashtu mund të japin kontribut të rëndësishëm në parandalimin e keqtrajtimit fizik, gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënë, në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe, kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.<sup>12</sup>
34. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale<sup>13</sup> dhe Praktika Standarde e Veprimit<sup>14</sup> e DShB-së përcaktojnë obligimin e autoriteteve kompetente që i burgosuri i sapo pranuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.
35. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës<sup>15</sup>, Rregullat Evropiane të Burgjeve<sup>16</sup> dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>17</sup>
36. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe në dokumentacionin relevant, të sapo pranuarit, brenda 24 orëve, i nënshtrohen kontrolleve mjekësore në pajtim me LESP-në dhe me Praktikën Standarde të Veprimit të DShB-së.

### **Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore**

37. Sa i përket konfidencialitetit të shërbimeve mjekësore, MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në rastet kur prania e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.
38. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit,<sup>18</sup> e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale<sup>19</sup>, me standardet e KPT-së<sup>20</sup>, si dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë:

---

<sup>12</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8/>

<sup>13</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

<sup>14</sup> Praktika Standarde e Veprimit, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

<sup>15</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf/](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf/)

<sup>16</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d/>

<sup>17</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: [https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45\\_113.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf)

<sup>18</sup> Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

<sup>19</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

<sup>20</sup> Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943/>

Rregullat e Mandelës<sup>21</sup> dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>22</sup>

### **Masat disiplinore**

39. Sipas legjislacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vetmia.<sup>23</sup> Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënimet si në vijim: kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korrespondencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike. Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua nga Drejtoria e QPL-së se tash për tash nuk ka të dënuar të ndëshkuar me këtë masë disiplinore. MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga të burgosurit lidhur me shqiptimin e masave disiplinore nga drejtori i QPL-së.

### **Kontakti me botën e jashtme**

40. MKPT-ja konsideron se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo nga të afërmit e tjerë, janë të rëndësishme thelbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të burgosurve.

41. Legjislacioni në fuqi,<sup>24</sup> për rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe kanë të drejtë për një vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Sipas drejtorit të QPL-së, të burgosurit kanë të drejtë për një vizitë në javë. Vizitat në rastin e të paraburgosurve autorizohen nga gjykata kompetente. Nga intervistat me të paraburgosurit dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit relevant, del se në përgjithësi të paraburgosurit kanë nga një vizitë në javë të autorizuar nga gjykata kompetente.

42. Sa u përket thirrjeve telefonike, neni 60 i LESP-së përcakton se i dënuari ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike. Në rastin e të paraburgosurve, këto telefonata autorizohen nga gjykata kompetente. Bazuar në informatat e siguruar nga drejtori i QPL-së dhe nga pohimet e të paraburgosurve, atyre u lejohen dy telefonata në javë, të cilat janë subjekt i lejes së gjykatës kompetente. Ndërsa në rastin e të dënuarve nuk ka kufizime.

43. MKPT-ja vizitoi edhe sallën e vizitave familjare, e cila ofron kushte të kënaqshme për të pranuar vizita familjare, si dhe ofron mundësinë që i burgosuri të ketë kontakt të drejtpërdrejtë (nuk ka barriera ndërmjet tyre) me familjarin apo personin nga i cili vizitohet.

### **Procedura e parashtrimit të ankesave**

---

<sup>21</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf/](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf/)

<sup>22</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: [https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45\\_113.pdf/](https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf/)

<sup>23</sup> Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

<sup>24</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.



44. Standardet e KPT-së theksojnë rëndësinë e sistemit efektiv të parashtrimit të ankesave dhe e konsiderojnë atë si garanci themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit.<sup>25</sup>
45. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën, sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të ShKK-së. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe ministri i Drejtësisë.<sup>26</sup>
46. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në QPL gjenden kutitë e ankesave, të vendosura nga ShKK-ja, kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe ato të DShB-së. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
47. Po ashtu, ata mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave), përmes postës së rregullt, e cila, sipas LESP-së, nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre.
48. MKPT-ja vërejtë se të burgosurve në QPL u ofrohet mundësia adekuate për parashtrim të ankesave dhe të kërkesave, i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të burgosurve në këtë qendër, në pajtim me LESP-në. Po ashtu, QPL-ja regjistron të gjitha ankesat dhe kërkesat e të burgosurve në dosjet e tyre administrative. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit, sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë.

#### **Personeli i QPL-së dhe çështje të ndërlidhura me sigurinë**

49. Sipas drejtorit, QPL-ja përballet me mungesë të zyrtarëve korrektues, pasi që disa zyrtarë korrektues janë duke u shkolluar në Akademinë për Siguri Publike. Sipas drejtorit të QPL-së, disa zyrtarë korrektues kanë pasur trajnime në kuadër të projektit të binjakëzimit me Shërbimin Korrektues Finlandez, trajnime të organizuara nga Këshilli i Evropës, nga UNICEF-i dhe nga Komiteti Holandez i Helsinkit. Përveç këtyre trajnimeve, disa zyrtarë korrektues u dërguan për trajnim edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
50. Sikurse në qendrat tjera korrektuese, MKPT-ja vërejtë se zyrtarët korrektues janë të pajisur me të ashtuquajturin *peper spray*, të cilit i ka skaduar afati i përdorimit. Në përgjithësi, hapësirat e QPL-së janë të pajisura me kamera të sigurisë, ku shumica e tyre janë funksionale dhe të cilat, nga pikëpamja e KPT-së, ato janë garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik dhe për akuza eventuale të rrejshme ndaj zyrtarëve korrektues. Sipas drejtorit të QPL-së, tek organet kompetente të ShKK-së janë dërguar kërkesa për kamera shtesë.

<sup>25</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 27-të i Përgjithshëm, paragrafi 68. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16807bc668>.

<sup>26</sup> Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: Në ankimin e paraqitur, drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

## REKOMANDON

### Ministrisë së Drejtësisë:

- Të shtohen aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit në QPL, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale dhe me LESP-në, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.
- QPL-ja të furnizohet me dyshekë të rinj dhe cilësorë.
- Të rinovohet kati i dytë i QPL-së, në mënyrë që kushtet e akomodimit për të burgosurit të jenë në pajtim me LEPS-në dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.
- Të njoftohet MKPT-ja për çështjen e përdorimit të *peper spray* me afat të skaduar.

### Ministrisë së Shëndetësisë

- Të rritet numri i stafit të mesëm në njësinë shëndetësore në QPL, sipas nevojës.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

  
Hilmi Jashari

Avokat i Popullit